

EGZONIMIA HISTORIKE (Kontribut qasjes teorike*)

Igor Gostl

Enti Leksikografik
i Jugosllavisë — Zagreb

KUD 809.198.3—311
802/809—311
Punim studimor

Marrë për botim më 21 shtator 1987

Përmbajtje e shkurtër Në këtë punim, autori bën fjalë për toponimet dygjuhësore apo shumëgjuhësore, të emërtuara me termin egzonime historike. Ai përpiket të japë kontributin e vet në çështjen e përdorimit të drejtë të egzonimeve në komunikimin ndërkombëtar në pajtim me porositë e konferencave të Kombeve të Bashkuara lidhur me çështjen e standardizimit të emërtimeve gjeografike në mbarë botën. Duke trajtuar këtë problem mjaft kompleks e të rëndësishëm në fushën e toponomastikës, autori zë ngoje edhe egzonimet shqipe, të cilat duhet shkruar në trajtat e tyre burimore, por kur është fjala në nivel jugosllav, ato vihen në kllapa, si: *Skopje (Shkup)*, *Bitola (Manastiri)*, *Uroševac (Ferizaj)*, kurse emërtimet gjeografike të huaja i ndeshim të paraqitur fonetikiht: *Minhen*, *Bolonjë*, *Vjenë*, *Ploeshti*, *Nagjkanizha*, etj. Ndërkaq emërtimet e objekteve më të mëdha ose të njohura gjeografike shkruhen vetëm në gjuhën shqipe: *Alpet Karnike*, *Lugina e Trakisë*, *Gadishulli Ballkanik*, etj. Në këtë punim zgjidhen edhe shumë çështje të transfonemizimit ndërkombëtar të një varg toponimesh të vendbanimeve dhe emërtimeve të shumta gjeografike. Këtu bëhet edhe për emërtimet e përkthyer dhe emërtimet dygjuhësore sipas gjuhëve të kombeve e të kombësive të vendit tonë dhe të popujve të botës e veçorive specifike të gjuhëve të tyre.

Duke pasur parasysh përdorimin e kufizuar të nocionit *egzonim*, i cili është inkuadruar vonë në terminologjinë e linguistikës dhe onomastikës (toponomastikës), është e nevojshme që ky nocion të shpjegohet e të sqarohet më gjerësisht.¹

* Me qenë se punimi trajton çështjen e egzonimeve, toponimet sllave i kemi lënë në trajtën e tyre origjinale edhe gjatë përkthimit ashtu siç i ndeshim edhe toponimet në gjuhë të tjera të popujve të botës.

¹ Shihet qartë mungesa e këtij termi në shkrimet tona terminologjike, në fjalorë, leksikone dhe në enciklopedi.

Definicioni më i thukët, por jo edhe më i saktë i këtij nocioni do të mund të shpihet në egzonim si një emër gjeografik, që gjendet në një territor të një treve gjuhësore tjetër. Një shpjegim më të plotë të këtij nocioni sjell M. Peterca në lëndën leksikore për standardizimin emrave toponimikë. Ai pohon se egzonimi është emërtim gjeografik, i cili përdoret në mbarë shtrirjen e një gjuhe për një objekt të caktuar gjeografik që gjendet jashtë territorit në të cilin kjo gjuhë ka status zyrtar, kurse dallohet nga trajta e përdorur në gjuhën zyrtare ose në gjuhët zyrtare të atij vendi të cilit i përket ky objekt². Këtu *objekti gjeografik* si nocion i përgjithshëm emërton çdo pjesë të sipërfaqes së Vendit që ka individualitet gjeografik përmbajtja e të cilit është e caktuar me gjerësi sipërfaqësore, është e njohur dhe terminologjikisht e sqaruar³. Egzonimi, për nga pikëvështrimi i shkencës së gjuhësisë dhe të gjeografisë është një emërtim i përvetësuar për toponimet tradicionale, e më së shpeshti për ojkonime ose horonime, hidronime dhe morfonime. Trajatat e emrave gjeografikë, të përfutuara me anë të veprimeve transfonemizuese ose transliteruese, nuk i konsiderojmë egzonime⁴.

Nëse mbështetemi në kriteret e klasifikimit diakronik të shqyrtimit të çështjes në fjalë, që është një metodë e kërkimeve toponimike, atëherë është e mundshme që ndarja të kushtëzohet në egzonime *historike* (arkaike) dhe në egzonime *kurente*.

Sipas kriterëve të klasifikimit, të parat nuk kanë vlerë të përdorimit ose ajo është shpënë në vlerën letrare-historike. Egzonime të këtilla janë: *Jakin* (Ancona), *Turin* (Torino), *Stambol* (Istanbul), *Mleci* (Venecia) ose egzonimet çeke të futura herë-herë në kuptimin e sllavizmit ilirik *Lipsko* (për Leipzig), *Monakov (o)* (München) *Drazdani* (për Dresden).

Edhe pse shtresa tradicionale e egzonimeve të kategorisë së dytë nuk është patjetër e re, vlera, e përdorimit të tyre shtrihet në standardin e sotëm gjuhësor, duke u siguruar në këtë mënyrë

² *Terminologjija o standardizaciji geografskih naziva — prilog izradi jugoslovenskog terminološkog rečnika*, Zbornik radova geodetskog fakulteta Sveučilište u Zagrebu, niz A, svezak 33, Zagreb, 1982.

³ *Emërtimi gjeografik* sipas lëndës së përmendur leksikore për standardizimin e shprehjeve toponimike, është pronë e objektit gjeografik në sipërfaqen e Tokës. Shërben për të njohur objektin gjeografik dhe orientimin gjeografik.

⁴ Për egzemplifikimin e veprimit të transfonimizimit po sjellim: *London* (transfonimizim jopreciz, fizionomia e toponimit reflekton drejt grafisë burimore), *Minhen*, *Lester*, *Lajpcig*, *Varšava*, *Marsej*, *Tuluz*, etj.

Për egzemplifikimin e veprimit të transliterimit: *Lenjograd*, *Moskva*, *Varna*, *Kijev*, *Sofija*, etj.

Nga egzonimet dallohen edhe *emërtimet* tona *autoktone* (emrat gjeografikë në gjuhën dhe shkrimin burimor), siç janë *Celovec*, *Trbiž*, *Beljak* (format sllave). Këta emra prej egzonimesh siç janë *Beç* ose *Rim* (për sllavishten) dallohen për arsye se në gjuhën etnike autoktone që edhe sot është e pranishme në territorin e huaj edhe për ne është e afërt.

egzonimeve praninë edhe në hartën gjeografike (pa marrë parasysh a është fjala për hartografinë zyrtare ose shkollore) si në shkrime ashtu edhe në fjalë. Egzonime të këtilla janë: *Carigrad* (Istambull), *Solun* (Thessaloníki), *Beç* (Wien), *Rim* (Roma), *Drač* (Durrës ose Durrësi), *Skadar* (Shkodër ose Shkodra) etj.

Nuk është e parëndësishme të analizohen nga aspekti historiko-gjeografik dhe linguistik disa nga egzonimet e zëna ngoje:

JAKIN (Ancona) sipas Fjalorit të gjuhës kroate ose serbe të Akademisë Jugosllave të Shkencave dhe Arteve (në tekstin e mëtejshëm Fjalori i Akademisë) (Rječnik hrvatskok ili srpskog jezika Jugoslavenske akademije znanosti i umjetnosti), dëshmia më e vjetër e egzonimit daton nga shekulli XV. E shënon Fjalori i Mikalinit *Blago jezika slovinskoga*... i vitit 1649 dhe i Della Bellinit nga viti 1728. Këtë ojkonim e ndeshim edhe në *Ričoslovník iliričkoga i nemačkog jezika*... të Voltiçit të vitit 1803, në Fjalorin e Stullit dhe të Karaxhiçit *Srpski rječnik*... i vitit 1818 e të Daniçiqit *Rječnik iz književnih starina srpskih* i vitit 1863. Duke shpjeguar etimologjinë Fjalori i Akademisë thekson se... „para *a*-së është vënë *j*-ja, kurse *n*-ja ka rënë, ndërsa *o*-ja është shndërruar në *i* (krahas Rim, Labin, Skradin)”. Petar Skoku në *Etimologijski rječnik hrvatskog ili srpskog jezika*, botim i ASHAJ më 1971 (në tekstin e mëtejshëm Fjalori i Skokut) vëren se si „prapashtesa greke *-ōna* gjendet këtu në të njëjtën trajtë ashtu siç e ndeshim edhe te ilirishtja *-ona* te *Aenona* (Nin), *Scardona* (Skradin), *Stolpona* (*Stupin*), *Glemona* (Humin), *Salonae* (Solin) që është dëshmi se të gjitha këto trajta janë me lashtësi të njëjtë, që do të thotë se janë nga koha e kontakteve të para në Adriatik (të shekullit VII)”.

MLECI (Venezia, Venecia). — Fjalori i Akademisë thekson se toponimi *Mleci* shfaqet kryesisht në plural e përjashtimisht në singular (në Fjalorin e Karaxhiçit si *Mletak* që bazohet vetëm në dy shembuj të këngëve popullore). Trajta plurale me gjasë është përfutur sipas pluralit latin *Venetiae*, *Venetiarum*. Trajta *Mleci* u përfutur nga *Bneci* nëpërmjet trajtës kalimtare *Mneci* (me asimilimin *bn > mn* dhe me disimilimin *mn > ml*: „ku *n*-ja pas *m*-së kaloi në *l* siç e ndeshim edhe te *mlogo*, *mliti*, *najamlík*; në vend të *l* herë-herë ndeshim edhe *lj*”. Për trajtën *Bneci* kemi dëshmi në literaturën leksikografike të shekujve XV—XVIII. Këso dëshmish sjell edhe fjalori pesëgjuhësh i Faust Vrançiqit të vitit 1595 (*Bnetci*), *Rječosližje iliričko, italijansko, latinsko* të Joakim Stullit të vitit 1806 dhe te Fjalori i Daniçiqit. Trajtën *Mleci* e ndeshim te fjalori i Ardëli Della Belle të vitit 1728 te fjalorët e Voltiçit dhe të Karaxhiçit. Për trajtat më të lashta të fizionomisë të këtij egzonimi dëshmonë edhe literatura e shekullit XVII.

TURIN (Torino). — Pranë këtij ojkonimi Fjalori i Akademisë citon Fjalorin e Vitezoviçit: „Augusta Taurinorum, Turin,

grad... Ta pushtoj Italinë e rrafshët... prej Milanos dhe qytetit Turn... „si dhe shembulli i Kaçiqit: „Otvor” bila jadra da mi do-brodimo do Turina grada)” (Hap velat e bardha që të lundrojmë deri te qyteti Torino).

STAMBOLL (Istambull). — Sipas Skokut ky egzonim arkaik është një greqizëm që u përftua përmes turqishtes *Istambol*, prejardhjen e të cilit e gjejmë në sintagmën e greqishtes së re (εἰς τὴν πόλιν, në qytet (*np > mb*)).

Pasojnë informime të shumta lidhur me disa egzonime vlera përdoruese e të cilëve nuk është kryesisht historiko-letrare:

BEČ (Wien). — Derisa Fjalori i Akademisë kufizohet në informimin lapidar për vërtetësinë e egzonimit të shekullit XVI e këndeje dhe praninë e tij „në të gjithë fjalorët, përveç të Vraniçiqit dhe të Mikalinit”, Skoku, ndërkaq në një informatë voluminoze se ky emërtim yni sot i përgjithshëm për kryeqytetin e Austrisë nuk ka kurrfarë lidhjeje me emërtimin kelt *Vindobona* që u ruajt nga gjermanët: *Wien* përballë trajtës *Wieden* (një pjesë e Vjenës dhe lumthi i emërtuar kësisoj). Sipas *Wieden* është sajuar egzonimi çek *Videň* dhe ai polonez *Wiedeń*. Vienna është trajta e latinizuar sipas trajtës *Wien*.

Toponimin Beč e ndeshim edhe në toponomastikën hungareze (Bécs), nga e cila zatën edhe e kemi marrë, pastaj në turqishten, shqipen e cincarishten (vllahishten). Përmbajtje të rëndësishme toponimike ka apelativi hungarez *bécs* të cilin nuk e gjejmë vetëm në emërtimin e vjetër për Austrinë (Bécsország), por e ndeshim shumë shpesh edhe në toponomastikën hungareze.

Petar Skoku sjell këto toponime: *Uj-Bécs*, *Kis-Bécs*, *Szamos-Bécs* si dhe kompozitën *Becskerek*. Në hungarishte dhe rumunishte apelativi *beč* me të cilin janë shprehur veçoritë historiko-geografike (të peisazhit) të një hapësire, ka domethënien *bodrum*. Kuptimin e kësaj fjale Skoku e lidh për fortesat avare prej dheu „që iu përgjigjet toponimeve tona *Zemun* dhe *Zemunik*”.

Është me interes të veçantë se as sllovenët, të cilët si sllavë të Alpeve gravitojnë drejt këtij qyteti, gjithashtu nuk e kanë ruajtur emrin e keltëve *Vindobona*⁵.

Duke shqyrtuar toponimin kelt *Vindobona* Skoku ishte i mendimit se ky emër është i përbërë nga mbiemri *vindos* (i bardhë) dhe nga emri *bona* (qytet). Në qoftë se ky supozim është i saktë, përfundon Skoku, atëherë *Vindobona* do të kishte të njëjtin kuptim si edhe emri i qytetit *Beograd*.

CARIGRAD (Constantinopolis, Istanbul). — Ky egzonim ka të njëjtin kuptim siç do të thuhej *carski grad* (qyteti mbretëror).

⁵ Egzonimi slloven paraqitet me trajtën *Dunaj*.

Dëshmitë për këtë i ndeshim qysh në shekullin XIII dhe në të gjithë fjalorët, përveç fjalorëve të Vrançiqit dhe të Habeliqit.

BRAC (Durrës). — Mbështetur në Fjalorin e Akademisë ky egzonim paraqitet qysh në shekullin XIII. Këtë e dëshmon Ardela Della Bella në fjalorin e vet *Dizionario Italiano, Latino, Illirico* të botuar në Veneci më 1728, pastaj te fjalorët e Karaxhiçit dhe të Daniçiqit.

RIM (Roma). — Trajta e këtij egzonimi është përftuar nga trajta e kryehershme Rymъ; ku *y* është përdorur në vend të *ō*-së romane dhe *ū* si në egzonimet *Jakin, Labin, Skradin, Trogir* etj. por këtu qysh herët kaloi në *i* (sllavishtja e lashtë kishtare *Rimъ* dhe *križъ* nga furlanishtja *cruge* (lexo *Kruže*). Këtë e shënon Vrançiqi në *Dictionarum quinque nobilissimarum Europae linguarum, Latinum, Italicae, Germanicae, Dalmaticae et Ungaricae* të vitit 1595 si dhe Maikalini në *Thesaurus, Lexicon Latinum interpretatione Illyrica, Gramatica et Hungarica*. Këtë e ndeshim edhe te Andrija Jambreshiqi në vitin 1742, *Gazophylacium* të Ivan Bolesantcit të vitit 1740 (Rim vseh verešev glava i istolno mesto s. oca pape... v Rim idem... nikaj vekšega nemreš videti od Rima...); (Roma ishte kryeqytet dhe seli e atit të shenjtë papës... po shkoj në Romë... asgjë nuk mund të shohish më të bukur se Romën...); e përmend edhe Ardelia della Bella, fjalori i Karaxhiçit e të tjerë.

SKADAR (Shkodër). — Dëshmi ndeshim ndër fjalorët, e Bellinit (krahas trajtave Scutari, città in Albania, Scodra), të Karaxhiçit (Skutari, Scodra) dhe të Daniçiqit (me një varg shembujsh të korrigjimesh të vjetra). Sipas Skokut trajta „Skadar reflektohet nga trajtat romane edhe greke *Scodra* (po ashtu edhe trajta plurale *Scodrae*, që dëshmon se në periudhën romake ishte një qytet i madh, siç ishte *Salonae*)... Raportet e trajtës italiane *Scutari* me atë të latinishtes nuk është lehtë të shpjegohen”.

SOLUN (Thessaloníki). — Sipas fjalorit të Skokut egzonimi u përftua nga toponimi grek Θεσσαλονίκη: sipas ligjit të haplologjisë të tipit të greqishtes së re të rrokjes së parë *so* dhe të latinitetit ballkanik të rënies së prapashtesës — *Lκη*. „Sipas kësaj trajta sllavojugore *Solun* u përftua nga trajta ballkano-latine *Salona*, madje kjo prej lokativit *Salonae*. Ku *o* nuk kaloi në *i* si te *Solin*, prandaj për këtë arsye *o*-ja greke në këtë toponim është e shkurtër, e cila kalon në *u* (drum)”.

Trajta italiane *Salonichi* doli nga greqishtja e re Σαλονίκη, nga e cila gjithashtu u përftua edhe trajta turke *Selanik*.

Fusha semantike e toponimeve është shumëshiresore: në të reflektohet, ndër të tjera, varësia politike, përkatësia etnike, kontinuiteti i popullzimit. Me një fjalë, ajo shpreh realitetin ekzistues gjeografik, politik ose etnik. Kështu, toponomastika merr jo ve-

tëm nuanca kuptimore profesionale shkencore, por kryesisht merr edhe nuanca kombëtare e politike apo gjeopolitike.

Bashkë me ngarkesën politike, egzonimi duke shumëfishuar emrat për të njëjtën gjë, ka filluar të gjenerojë „zhurmë në kanal” do të thotë të pengojë komunikimin (ndërkombëtar). Prandaj, nuk habit fakti se toponomia në përgjithësi, kurse egzonimia në veçanti, u bë objekt jashtëzakonisht i theksuar në katër konferencat e deritashme të Kombeve të Bashkuara lidhur me standardizimin e emrave gjeografikë.

Në Konferencën e Dytë të KB lidhur me standardizimin e emrave gjeografikë, e cila u mbajt në maj të vitit 1972 në Londër (Jugosllavinë e përfaqësoi Dr. Branko Borčić), ku interes të veçantë zgjoi rezolucioni nr. 29, ku flitej për zvogëlimin e numrit të egzonimeve (këtu egzonimi për herë të parë u theksua si emërtim). Konferenca këshillon që në kuadër të standardizimit ndërkombëtar të emrave gjeografikë përdorimi i egzonimeve në hartat gjeografike dhe në publikimet kombëtare të reduktohet në mënyrë të njëjtë. U vendos që në raste kur egzonimi pengon komunikimin të shënohet edhe emri zyrtar (burimor). Konferenca⁶ gjithashtu miratoi rezolucionin me të cilin porositen të gjitha vendet të përgatisin listën e egzonimeve që janë në përdorim të përhershëm, me qëllim që numri i tyre të zvogëlohet, kurse rezultatet e një reduktimi të këtillë të njoftohen.

Në Konferencën e Tretë të KB të standardizimit të emrave gjeografikë të mbajtur në gusht dhe në shtator të vitit 1977 në Athinë (Jugosllavinë e përfaqësoi Dr. Miroslav Peterca) ku problematika e egzonimeve u shqyrtua në rezolucionet nr. 17, 18 dhe 19. Me Rezolucionin nr. 17 konferenca vërteton se është e nevojshme të largohemi nga formimi i egzonimeve të reja. Rekomandohet që çdo shtet për vendet e çliruara tash vonë, po ashtu edhe për vendet që miratojnë emra të rinj gjeografikë, të përdoren ata emra, të cilët, aq sa është e mundshme zyrtarisht t’u afrohen emërtimeve lokale të vendeve përkatëse. Me rezolucionin nr. 13

⁶ 29. *Exonyms*

The Conference recognizing the desirability of limiting the use of exonyms recommends that, within the international standardization of geographical names, the use of those exonyms designating geographical entities falling wholly within one State should be reduced as far and as quickly as possible.

The Conference recognizing that exonyms are losing ground, even in national use,

1 Recommends that in publications intended only for national use the reduction of exonyms should be considered;

2. Further recommends that in those cases where exonyms are retained, the local official forms should be shown in addition as far as possible.

(Second United Nations Conference on the Standardization of Geographical Names, London, 10—31 May 1972, Volume I Report of the Conference, United Nations, New York, 1974).

konstatohet një përparim në këtë fushë të toponimisë (por fatkeqësisht, jo në të gjitha vendet), sepse një numër i caktuar shtetesh kanë identifikuar dhe kanë përgatitur ose janë duke përgatitur listën e egzonimeve të tyre. Duke dëshmuar se me zvogëlimin e tipave të ndryshëm të egzonimeve, varësisht nga gjuhët, kërkohen edhe rrugë të ndryshme të përdorimit të tyre, prandaj Konferenca rekomandon që shtetet e interesuara të përpunojnë regjistrimet e përkohshme të egzonimeve duke i veçuar ato egzonime të cilat janë të përshtatura të evitohen që në fillim.

Rezolucioni nr. 19 merret me çështjen e përpunimit të regjistrimit të egzonimeve, duke precizuar zbatimin e rezolucionit nr. 28 të aprovuar në Konferencën e Dytë. Konferenca rekomandon që nga lista të evitohen këto kategori egzonimesh: ato që dallohen nga emërtimet zyrtare vetëm nga lëshimet, duke i shtuar ose duke ndërruar shenjat diakritike ose nyjet; ato të cilat dallohen nga emri zyrtar vetëm në saje të deklinacionit ose derivateve; ato të cilat janë përfutur nga përkthimi i termave gjenerike.⁷ (I ndeshim më shpesh në shtresën e emrave gjeografikë: *gore* në *Zelen-gorë*).

Konferenca e Katërt e standardizimit të emrave gjeografikë u mbajt në gusht dhe shtator të vitit 1982 në Gjenevë (përfaqësues i Jugosllavisë ishte Blagoj Zashovi). Edhe në këtë Konferencë u vendos reduktimi i mëtejshëm i egzonimeve (rezolucioni nr. 20). Një numër i caktuar shtetesh përgatitën listën e egzonimeve të tyre. U konstatua gjithashtu se të gjitha shtetet nuk po veprojnë në harmoni me rezolucionet e aprovuara. Konferenca vendosi që të shqyrtohen vijimisht metodat dhe parimet që kanë të bëjnë me zvogëlimin e egzonimeve, në mënyrë që të sigurohet zbatimi sa më i shpejtë i rezolucionit. Konferenca rekomandon që egzonimet, përdorimi i të cilëve shkakton probleme ndërkomëtare, të përdoren me një kujdes të madh dhe të shkruhen në kllapa pranë emërtimeve të tanishme zyrtare (burimore).⁸ Së këndejmi del edhe obligimi për shkruarjen dygjuhësore të emrit gjeografik për toponimet që gjenden në vendet e tjera, e për të cilat në gjuhët tona ekziston egzonimi përkatës. Para vendit tonë është vënë detyra që kërkon përpunim urgjent të regjistrimit të egzonimeve në gjuhën kroate ose serbe apo serbokroate, në gjuhën maqedone dhe në atë sllovene.

⁷ 17. *Names of countries*

The Conference recognizing the desirability of avoiding new exonyms recommends that every country use in its language (s), for newly independent countries and for countries that adopt new names, those names, that correspond, as far as possible, to the official local names of the countries concerned.

18. *Study of exonyms*

The Conference noting that, in accordance with resolution 28 of the Second United Nations Conference on the Standardization of Geographical

Vendi ynë përkrah parimet dhe rekomandimet e Organizatës së KB lidhur me egzonimet: zbatimi i këtyre parimeve duhet domosdo të shprehet edhe në hartografinë tonë, njësoj si nga aspekti zyrtar, ashtu edhe nga ai shkollor. Gjatë kësaj duhet pasur kujdes për ndryshimet, për cakun dhe për qëllimin e njërës dhe tjetrës hartografi. Reduktimi i egzonimeve të bëhet aq sa është e mundur ose disa sosh të shënohen në kllapa, madje kjo në një numër sa më të vogël rastesh, duke qenë shenja orientuese në hartografinë zyrtare aq sa kërkon kultivimi i procesit arsimor dhe shtron solucione të tjera (për qëllime të caktuara) në hartografinë shkollore. Këtu egzonimi *duhet* të zëvendësohet, por

Names, progress has been made in the matter of exonyms in so far as a number of countries have identified and prepared, or are preparing, lists of their own exonyms, recognizing, nevertheless, that progress has not been uniform in all countries, further recognising that the reduction of both different types of languages and different linguistic categories of exonyms require different approaches, recommends that (a) The countries concerned continue to work on the preparation on the provisional lists of exonyms, singling out those suitable for early deletion; (b) The group of Experts contribute to the exchange of information among the countries concerned on the results of the studies of different categories of exonyms made by those countries.

19. Lists of exonyms

The Conference considering that resolution 28 of the Second United Nations Conference on the Standardization of Geographical Names calls for each country to prepare a list of exonyms currently employed ... noting that the implementation of resolution 28 in its present form must result in enormous lists of doubtful value, recommends that the lists referred to in resolution 28 should not contain the following categories of exonyms: those differing from the official name only by the omission, addition or alteration of diacritics or the article; those differing from the official name by declension or derivation; those created by the translation of a generic term.

(Third United Nations Conference on the Standardization of Geographical Names, Athens, 17 August—7 September 1977, Volume I Report of the Conference, United Nations, New York, 1979).

20. Reduction of exonyms

The Conference, noting that, in accordance with resolutions 18 and 19 of the Third United Nations Conference on the Standardization of Geographical Names, further progress has been made in the reduction of the number of exonyms used and a number of States have prepared lists of their own exonyms, realizing that the reduction of exonyms used has not been carried out with the same intensity by all States, realizing further that the methods and principles aimed at a reduction of the number of exonyms used should constantly be reviewed for expeditious implementation of the resolution and understanding that not all countries can govern the content of maps and atlases published within their territories, recommends that exonyms giving rise to international problems should be used very sparingly and published in parenthesis with the nationally accepted standard name.

(Fourth United Nations Conference on the Standardization of Geographical Names, Geneva, 24 August—14 September 1982, Volume I Report of the Conference, United Nations, New York 1983).

i vënë në kllapa e në pozitë sekondare: trajtën primare duhet ruajtur edhe më tej për emërtimin autokton të vendeve, duke e shkruar me grafi burimore, e cila në disa raste shoqërohet edhe me shqiptim të përafërsishëm të gjuhës përkatëse. Është fakt se hartografia shkollore në RS të Kroacisë një formë të këtillë është duke e zbatuar një kohë bukur të gjatë.⁹

Për arsye të kompleksitetit të shënimit të emrave gjeografikë në hartat e botimit II të Enciklopedisë Jugosllave do të ishte e udhës ta njoftojmë lexuesin, së paku në nivel të trajtimit të egzonimeve për masat dhe solucionet e ndërmarra, të cilat sa po realizohen në vëllimet e para në gjuhën kroate ose serbe apo serbokroate (publikimet me alfabet latin dhe çirilik), në gjuhën sllovene, maqedonase, hungareze dhe në gjuhën shqipe.

Për një përpunim gjithpërfshirës të çështjes komplekse, Redaksia Qendrore e Enciklopedisë Jugosllave ka formuar Kolegjin profesional për hartografi dhe ka konsoliduar këto parime në të cilat mbështeten themelet e emrave gjeografikë të gjashtë vëllimeve të „Jugosllavikës”:

- I Parimi i së drejtës së çdo kombi dhe kombësie të RSFJ-së që të përdorë emrat në gjuhën dhe trejtshkrimin e vet;
- II Parimi i respektimit të shënimit dygjuhësor të toponimeve
 - a) në territore etnikisht të përziera të RSFJ-së (në KSA të Kosovës dhe në KSA të Vojvodinës)
 - b) në trevat etnike kufitare sllovene, kroate, serbe dhe maqedonase
- III Parimi etimologjik i paraqitjes së toponimeve në botimet e gjuhës kroate ose serbe (serbokroate me alfabet latin, në gjuhën sllovene dhe në atë hungareze;
- IV Parimi fonetik i shkrimit të toponimeve në botimet në gjuhën serbokroate (kroate ose serbe me alfabet çirilik), në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe;
- V Parimi i përdorimit të egzonimeve — vetëm në raste të arsyeshme — pranë trajtave burimore të toponimeve.

Në bazë të parimeve të parashtruara është elaboruar teksti *Mbi emërtimet gjeografike të hartave të botimit II të Enciklopedisë Jugosllave*, të cilin pas shqyrtimit të Kolegjiun profesional e aprovoi edhe Redaksia Qendrore e Enciklopedisë Jugosllave.

Në vazhdim do t'i qasemi atyre pjesëve të këtij dokumenti që kanë të bëjë me çështjen e egzonimeve.

⁹ Wien (Vin) Beč
Roma (Rim)

1. Botimi në gjuhën kroate ose serbe/serbokroate me alfabet latin

Toponimet në trevat ku është në përdorim alfabeti çirilik

Emërtimet gjeografike shkrimi burimor i të cilave është alfabeti çirilik shënohen në trajtë të transliteruar: Skopje, Bitola, Ovče Pole, Titov Vrv, Prespansko Ezero¹⁰.

Egzonimet dhe emërtimet dygjuhësore

Emërtimet tradicionale të vendit ose egzonimet shënohen në kllapa. Trajta burimore e toponimeve paraqitet etimologjikisht me grafi origjinale burimore: Roma (Rim), Wien (Beč), Thessaloniki (Solun), Durrës (Drač).

Emërtimet gjeografike të objekteve më të mëdha ose më të njohura gjeografike shënohen vetëm në trajtat e përkthyer në gjuhën kroate ose serbe: *Balkanski poluotok, Trakijska dolina, Karnske Alpe*.

2. Botimi në gjuhën serbokroate/kroate ose serbe me alfabet çirilik

Toponimet e trevave me përdorim të alfabetit latin dhe çirilik

Emërtimet gjeografike nga trevat me alfabet latin dhe çirilik shënohen në trajtat e tyre burimore, kurse shkruhen fonetikisht me shqiptim e grafi të çirilicës serbe: *Riječki zaljev, Bokokotorski zaliv, Ovče Pole, Tržaški zaliv*.

Disa nga toponimet, versioni i të cilave dallohet në serbokroatiste nga emërtimet tradicionale, do të shoqërohen edhe me emërtime tradicionale, duke u shkruar serbokroatisht në kllapa: Skopje (Skoplje), Bitola (Bitolj).

Egzonimet e përkthyer dhe emërtimet dygjuhësore

Emërtimet e huaja tradicionale (të familjarizuara) — egzonimet fonetikisht përdoren me grafi çirilike. Trajta burimore e toponimit shënohet në kllapa me grafi origjinale: Rim (Roma), Beč (Wien).

Në territoret e vendeve fqinje të banuara me popullsi autoktone sllovene, kroate, serbe dhe me popullsi maqedonase për

¹⁰ Shembujt e përmendur i përkasin sferës së pazgjidhur „të egzonimeve të vendit”.

emërtime gjeografike realizohet parimi i dygjuhësisë. Krahas trajtës së fonetizuar zyrtare në kllapa shënohet emërtimi autokton me alfabet çirilik: Klagenfurt (Celovec), Filah (Beljak), Ajzenštat (Željezno), Edesa (Voden).

3. Botimet me alfabet dhe gjuhë maqedonase

Emërtimet në trevat me alfabet latin dhe çirilik

(Si nën pikën 2, por me këto plotësime):

Disa toponime, grafia burimore e të cilëve dallohet nga emërtimet tradicionale të maqedonishtes, do të shoqërohen në kllapa me emërtime tradicionale: Beograd (Belgrad).

Egzonimet e përkthyer dhe emërtimet dygjuhësore

Emërtimet e huaja tradicionale (të familjarizuara) — egzonimet shënohen fonetikisht me grafi çirilike. Trajta burimore e toponimeve vihet në kllapa me grafi origjinale: Rim (Roma), Vienna (Wien).

4. Botimet në gjuhën dhe shkrimin slloven

Toponimet në territorin me alfabet çirilik

(si nën 1)

Egzonimet e përkthyer dhe emërtimet dygjuhësore

Emërtimet e huaja tradicionale (të familjarizuara) — egzonime vihen në kllapa. Trajta burimore e toponimit shënohet etimologjikisht, me grafi origjinale: Roma (Rim), Wien (Dunaj).

5. Botimi në gjuhën shqipe dhe me shkrim shqip

Emërtimet në territorin me alfabet çirilik

Emërtimet gjeografike grafia burimore e të cilave është çirilike paraqiten me trajtë të transliteruar me grafi të gjuhës kroate ose serbe: Ovče Pole, Titov Vrv, Lazaropole, Gevgelija.

Krahas shënimit të trajtës burimore, pranë disa toponimeve në kllapa shënohen edhe emërtimi tradicional i familjarizuar shqip, i ashtuquajtur egzonom i vendit: Skopje (Shkupi), Bitola (Manastiri).

Shkrimi i emërtimeve të huaja

Të gjitha emërtimet gjeografike paraqiten fonetakisht...¹¹
Minhen, Sigetvar, Bolonjë, Vjenë, Ploeshti, Nagjkanizha.

Emërtimet gjeografike më të mëdha ose objektet gjeografike më të njohura shënohen vetëm në trajtat e përkthyer në gjuhën shqipe: *Alpet Karnike, Lugina e Trakisë, Gadishulli Ballkanik.*

6. Botimi në gjuhën hungareze dhe me alfabet hungarez

Shkrimi e emërtimeve të vendit

a) në trevat me alfabet latin: emërtimet gjeografike paraqiten në trajtë etimologjike: trajta burimore e toponimit paraqitet me grafi origjinale: Rijeka, Riječki zaljev, Osijek, Karlovac, Varaždin.

b) në trevat me alfabet qirilik: emërtimet shënohen në trajtën e transliteruar, me grafema të gjuhës kroate ose serbe/serbokroate: Skopje, Gevgelija, Prespansko Ezero, Ovče Pole.

Emërtimet në territorin e KSA të Kosovës

Emërtimet gjeografike për të cilat me dispozitë të caktuar është pranuar dygjuhësia paraqiten në trajta dygjuhësore: serbokroatisht, kurse në kllapa shqip: Priština (*Prishtinë*), Peć (*Peja*), Uroševac (*Ferizaj*).

Emërtimet në territorin e KSA të Vojvodinës

Emërtimet gjeografike për të cilat me dispozitë të caktuar është pranuar dygjuhësia shënohen në trajtë dygjuhësore: hungarisht, kurse në kllapa serbokroatisht: Kanizsa (Kanjiža), Kiszegyes (Mali i doš), Zenta (Senta), Popolya (Bačka Topola).

Egzonimet e përkthyer dhe emërtimet dygjuhësore

Emërtimet e huaja tradicionale (të familjarizuara) — egzonimet shënohen në kllapa. Trajta burimore e toponimit paraqitet etimologjikisht me grafi origjinale: Wien (Bécs), Warszawa (Varso).

Emërtimet gjeografike më të mëdha ose objektet gjeografike më të njohura përdoren vetëm në trajtat e përkthyer në gjuhën hungareze: *Adriai tenger, Balkán félsziget.*

¹¹ Në të vërtetë ashtu siç i parasheh drejtshkrimi i shqipes.

Në territoret e vendeve fqinje të banuara me popullsi autoktone sllovene, kroate, serbe dhe popullsi maqedone realizohet parimi i emërtimeve gjeografike dygjuhësore. Krahas trajtës së emërtimeve në gjuhën e huaj zyrtare, në kllapa vihet emërtimi autokton: Villah (Beljak), Gorizia (Gorica), Timișoara (Temišvar), Felsőszevityán (Gornji Sveti Ivan), Bajaszentistván (Vancaga).

Në shembujt e botimit II të Enciklopedisë së Jugosllavisë jemi përpjekur të përcaktojmë qëndrimin tonë ndaj parimeve dhe rekomandimeve të KB-së lidhur me egzonimet. Duke zgjedhur disa përfaqësues më të rëndësishëm të prodhimit botëror hartografik — në periudhë kohore prej viteve 1973—1979, periudhë kjo e cila koincidon me mbajtjen e Konferencës së Dytë dhe të Tretë të Kombeve të Bashkuara për standardizimin e emërtimeve gjeografike — do të egzemplifikojmë qëndrimin e tyre ndaj çështjes egzonimike sipas toponomastikës moderne.

WORLD ATLAS¹² (Pan Reference BOOKS 1973, botim xhepi) përdor emërtime burimore, përveç shteteve edhe për dete që janë të shkruar në gjuhën angleze.

NUOVO ATLANTE geografico moderno (Istituto geografico de Agostini, Novara, 1976). Në këtë atlas, pa marrë parasysh përkatësinë politiko-territoriale, në mënyrë të dendur e të pasur janë inkuadruar egzonimet italiane.

Për të gjithë emrat gjeografikë, të cilët kanë variantin italian, është përdorur trajta italiane: *Grecia*, *Mare mediterraneo*, *Monaco* (për *München*), *Fiume* (për *Rijekën*), *Filadelfia*, *Baltimore*.

THE TIMES ATLAS OF THE WORLD (Times Books, 1971).

Emërtimet e shteteve janë shkruar anglisht. Pjesa dërmuese e toponimeve janë shkruar në trajtën burimore, por fizionomia shpesh i është përshtatur grafisë angleze. Për hidronimet më të vogla është përdorur emërtimi autokton: *Golfo de Cadiz*, *Golfe du Lion*. Kurse hidronimet e mëdha në tërësi janë përdorur anglisht, kurse nganjëherë kur përkatësia politike është e qartë, paraqiten edhe emrat origjinalë (burimorë): *Mediterranean Sea*, *Bay of Biscay* (*Mar Cantabrico*). Emrat e ishujve i ndeshim në origjinal, kurse emërtimi anglez paraqitet në kllapa (*Scilia /Sicily/*). Në hartat e kontinenteve ose në njësitë e mëdha kontinentale, të gjitha emërtimet janë anglisht.

INTERNATIONAL ATLAS (Westermann / Rand Mc Nally, 1979) kryesisht respekton emrat gjeografikë burimorë, përveç emrave të shteteve. Emrat e deteve të mëdhenj dhe të oqeanëve janë

¹² Për të dhënat e sjella i jam mirënjohës ing. B. Feldbauer-it nga pjesa e hartografisë të Entit Leksikografik të Jugosllavisë në Zagreb, i cili ka kryer analizat e cituara.

përdorur anglisht. Në hartat me përmasa më të mëdha në kllapa shënohet edhe emërtimi autokton.: (East China Sea /Donghai/). Vargmalet, të cilat shtrihen në disa shtete janë përkthyer në anglisht (Carpathian Mountains). Për ishuj janë përdorur emrat autokton, kurse në kllapa është shkruar anglisht: (Kriti /Crete/).

ATLAS INTERNATIONAL (Bertelsmann Lexicon-Verlag, Berlin, Stuttgart, 1979) për egzonime, kryesisht, respekton trajtën burimore autoktone. Emërtimin gjerman i disa makrotrajtave (dete, oqeanë) paraqiten në kllapa: (*Nihon Hai /Japanisches Meer/*). Kur nuk ka qenë e mundshme të caktohet trajta burimore për disa hidronime është përdorur emërtimi anglez, pranë trajtës gjermane ose franceze (veçanërisht në bregdetin perëndimor të Afrikës) që janë vënë në kllapa në saje të fuqisë dominuese koloniale në të kaluarën: (*Bay of Bengal /Golf von Bengalen/*), *Indian Ocean (Indischer Ocean)*. Emrat e shteteve janë shkruar në trajta origjinale (burimore).

Në hartën politike të botës është përdorur trajta gjermane (*Golf von Guinea, Ägypten, Jugoslawien*). Kjo vlen edhe për një pjesë të veçantë të atlasit, që pasqyron Evropën e Mesme.

Në faqet e para është theksuar nevoja për shtytjen ose mënjanimin e egzonimeve. Përpyekjet e Kombeve të Bashkuara lidhen për aspektin e komunikimit, duke pasur parasysh edhe ndriçimin politik kur këto paraqesin pengesa në komunikim, atëherë është fjala për kontekstin pragmatik. Ndërkaq, nuk do të ishte korrekte të supozojmë se mënjanimi i egzonimeve është i nevojshëm dhe i mundshëm në kontekstin historik ose në kontekstin arsimor. Egzonimet në nivel të enciklopedisë, hartografisë, informatikës etj. me një fjalë në nivelin e komunikimit ndërkombëtar, mund të paraqesin pengesa në kanalin komunikues, prandaj së këndejmi paraqitet nevoja për shtytjen ose mënjanimin e tyre. Në nivelin kulturor-historik dhe edukativ ndërkaq, qëndron nevoja e egzonimeve në një rrafsh sa më të gjerë, që do të thotë nevoja e kultivimit të egzonimeve brenda suazës së kulturës së gjuhës vetjake, si të atyre historike po ashtu edhe të atyre kurente (vijuese). Sepse egzonimet, këtë duhet thënë shkoqur, janë ngulitur thellë në vetëdijen dhe traditën tonë, janë rrënjësuar në trashëgiminë tonë historike dhe kulturore.

Lidhur me këtë çështje mbetet edhe shumë gjë për t'u thënë. Mjerisht ,hapësira këtu, nuk na lejon të shqyrtojmë edhe ndonjë çështje lidhur me egzonimet, sepse edhe qëllimi nuk ishte (dhe nuk mund të jetë) për ndriçimin e kësaj pjese të toponomastikës nga të gjitha aspektet: proplematika e egzonimisë është e një natyre mjaft fluide, prandaj edhe këtë tekst duhet konsideruar si një ndihmesë dhe përpjekje që disa pjesë të saj të fiksohen.

Igor Gostl

EXONYMS

Summary

The author expounds the problem of exonyms dividing them into historical and current. Resolutions of UN Conferences are considered as well as solutions proposed by the Yugoslav Lexicographical Institute. Practice of foreign world atlases is also surveyed.



